



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë
Kosovo Investment and Enterprise Support Agency
Agencija za Investicije i Podršku Preduzeća na Kosovu

FTESË PËR BIZNESE

Forumi i Biznesit ndërmjet Sllovenisë dhe Kosovës
B2B takime mes bizneseve sllovene dhe bizneseve kosovare

22 mars, 2024
Slloveni, Kranjska Gora

Me qëllim të promovimit të kompanive kosovare në gjetjen e tregjeve të huaja për eksport, rritjes së investimeve si dhe rritjes së gamës së produkteve për eksport, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT) përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) në bashkëpunim me institucionet përkatëse, fton bizneset vendore për pjesëmarrje në Forumin e Biznesit që do të mbahet me 22 mars, 2024 në Kranjska Gora në Slloveni, cili fokus të veçantë do të ketë realizimin e takimeve B2B ndërmjet bizneseve kosovare dhe bizneseve sllovene, përmes bashkëpunimit me agjencinë homologe sllovene për zhvillim të biznesit "Spirit Slovenia".

Qëllimi i Forumit të Biznesit në synim të thellimit të bashkëpunimit bilateral, është për të krijuar lidhje në mes ndërmarrjeve kosovare dhe ndërmarrjeve sllovene, për të hapur mundësi të reja për bashkëpunim në fushën e tregtisë dhe investimeve.

Bizneset vendore të ftuara për pjesëmarrje janë nga sektorët si në vijim:

-  Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK);
-  Ndërtimi;
-  Përpunimi i ushqimit;
-  Industria e tekstilit;
-  Industria e drurit dhe dizajni i brendshëm;
-  Turizmi.

Transporti lokal për realizimin e aktiviteteve në kuadër të forumit biznesor në Slloveni, do të organizohet nga Ambasada e Republikës së Kosovës, ndërsa akomodimi për bizneset pjesëmarrëse në këtë forum do të mbulohet nga partneri i KIESA-s "Caritas Switzerland" për datat 21 dhe 22 mars 2024.

Për të qenë pjesë e delegacionit, bizneset duhet dorëzuar në mënyrë elektronike dokumentet si në vijim:

1. Aplikacionin e plotësuar më të dhënat bazike të biznesit;
2. Dëshminë që biznesi është i regjistruar në Republikën e Kosovës;
3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të biznesit;
4. Deklaratën nën betim.

Bizneset, dokumentet e lartpërmendura duhet t'i dërgojnë në mënyrë elektronike më së largu deri më 18.03.2024 në orën 12:00, në e-mail adresën si në vijim:

⇒ invest.kiesa@rks-gov.net

Informata shtesë rreth aktivitetit mund të merren në MINT/KIESA përmes telefonit si në vijim:

⇒ +383 (38) 200 36 585

⇒ +383 (38) 200 36 586